

AKT-THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " Diarma Consulting " SH.P.K

NENI 1

Sot ne Tirane , me date 05 Korrik 2022 (dymijenezet e dy), Une ortak themelues:

Armando Nania, atësia **Carmine Antonio**, shtetas Italian, lindur në Torre del Greco , Itali dhe banues në Milano,Itali; lindur më 13/08/1976, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, poseduese e pasaportes biometrike Italiane me nr.YA4533761 .

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "**Diarma Consulting**".

NENI 2

Shoqeria Tregtare eshte vendase dhe quhet me emrin "**Diarma Consulting**" Sh.p.k emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 3

Selia Qendrore e Shoqerise "**Diarma Consulting**" Sh.p.k eshte ne adresen: Shoqeria do te kete seline e saj ne adresen **Rruga Rrapo Hekali ,Godina e Njesise Administrative nr 13 ,Kati 2**,Tiranë-Albania. (Nr.kontakti Celular 00393478419038, e-mail armando.nania@outlook.com).

NENI 4

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithe juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit, ne cdo vend te Komunitetit European.

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve mund te krijohen ose anulohen (ne rast se jane çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte shtetit.

Njesite e tjera strukturore te shoqerise, si Dege apo Perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje te tille lejohet dhe legjislacioni i vendeve te huaja, **normat e se drejtes nderkombetare private** dhe **parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme**.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontribute ne para dhe eshte 100,000.00 (njqind mije) Lekë, i formuar dhe nenshkuar nga Ortaket Themelues :

- **Ortaku themelues Armando Nania** Zoterues i 1(nje) kuote me vlere te pergjithshme 100,000.00 leke (njqindemije lek) qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ortaket me kerkese te Administratorit dhe ne perputhje me dispozitat ne fuqi te karakterit fiskal, ka te drejte te kryej pagesa apo te jape kontribute, ne kapital, ose financime ne favor te shoqerise, te cilat konsiderohen financime pa interes. Shuma e financiar, afati i kthimit dhe menyra e rimbursimit te tyre rregullohen me kontraten perkatese. Shumat e mesiperme mund te perdoren per te mbuluar humbjet ose trasferohen direkt ne rritjen e kapitalit ne perputhje me vendimin e asamblese se ortakeve.

00393478419038, e-mail armando.nania@outlook.com

NENI 6

Kapitali nuk mund te jete kurre i perfaqesuar me Letra me vlere.

NENI 7

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është **PA AFAT**, duke filluar aktivitetin e saj nga dita e rregjistrimit Person Juridik në Qendren Kombëtare të Rregjistrimit.

Me Vendim të Ortakëve kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshojë, dhe ky Vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Qendres Kombëtare të Rregjistrimit, kompetente për të bërë shenimet e nevojshme në Rregjistrin e Shoqërive Tregtar.

Shoqëria konform ligjeve të kohës në fuqi dhe autorizimeve perkatese duhet përjashtuar aktivitetet që ligji kufizon ka për objekt:

-Shërbime konsulence, projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje në fushën e Hoteleri Turizmit, të infrastrukturës, qendrave të biznesit etj.

-Zhvillim Kreditim financiar e sigurim i projekteve dhe veprave ndërtimore me karakter civil dhe industrial. Ngritje ndërtim lartësim ose shndërrim i çdo lloji ndërtimesi veprave ose makineri të nevojshme që i ndihmojnë dhe shërbejnë nevojave të shoqërisë,

- Këmbim valutash, transferime financiare, dhënie e konsulentëve në fushën juridike, financiare, marketingu, menaxhimi, investime dhe pasuri të paluajtshme

-Marrjen pjesë në Panaire kombëtare dhe ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me çeljen dhe zhvillimin e biznesit, në fushën e ndërtimit dhe të teknologjisë bashkëkohore të tij, me qëllim jo vetëm ekspozimin e gameve të prodhimeve ndërtimore të firmës por dhe për të mundësuar arritjen e marrëveshjeve kontraktore me persona juridik vendas dhe të huaj për zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit të përbashkët tregtar me to, si dhe **pjesëmarrje në Tendera brenda e jashtë vendit**

-Import, eksport, tregti të artikujve të ndryshëm Brenda dhe jashtë vendit.

-Projektim dhe zbatim të punimeve të ndërtimit, rikonstruksione, mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi dhe montimi në godina civile, industriale, bujqësore, turistike, shoqërore, veprave ujore, kanalizime të ndryshme, rrugë ura e vepra arti, punime komunale dhe të mjedisit, si dhe punime të të gjitha llojeve në fushën e ndërtimit e montimit. Në drejtim të projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të objekteve sportive, interiere, paisazhi, sipërfaqe të gjelbërta, lulishte dhe parqe. Projektim dhe zbatim të punimeve të ndërtimit të sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes, ventilimit dhe klimatizimit. Eksport-import dhe tregtim me shumicë e pakicë të të gjitha llojeve të materialeve dhe pajisjeve të ndërtimit, hidrosanitare, elektrike, të mallrave të ndryshëm industriale dhe mallra të të gjitha llojeve. Veprimtari i lidhur me asistencën teknike, të të gjitha shërbimeve të përmendura më sipër, etj. Vlerësimin e pasurive të paluajtshme për ndërtim dhe tokë tërësisht. Hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për problemet mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport vlerësimi të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi. Studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtimit të çdo lloji. Si dhe Hartimin e akteve të ekspertizës teknike për zjarret e rena.

1-Projektme Masterplane-Studime e plane rajonale Urbanistike, plane rregulluese të përgjithshme për qendra të banuara dhe qytete si dhe studime pjesore Urbanistike. Projektim - zbatim konstruktiv. Projektim - zbatim të objekteve të ndryshme me konstruksione metalike. Projektim dhe rievime për bazamente gjeodezike, projektme topografike dhe hartografike dhe fotogrametike. Studime gjeologjike - inxhinierike të trullit për të gjitha llojet e objekteve. Studime të Sizmiologjisë inxhinierike IO. Projektme të sinjalizimit rrugor. Projektimin e impjanteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë. Projektim vepra hidraulike. Projektim Arkitektonik :objekte civile, industriale, spitalore, turistike, vepra arti në infrastrukture, kulturi, administrative, interiere, paisazhi, hoteleri, sipërfaqe të gjelbërta, parqe, lulishte, Restaurim monumenteve të kulturës. Projekte Adaptimi. Dizajn grafik, Animacion, **Modelim, renderizim. Përpunim grafik projektesh** : Animacion, Modelim, renderizim,, Përpunim arkitektonik planimetrik, Makete me printer 3D, Makete me materiale të tjera. Projektim Konstruktiv :objekte civile, industriale, spitalore, turistike, vepra arti në infrastrukture,

kulti, administrative, perpunim konstruktiv ,projektim objektesh me shkalle te larte veshtiresie beton arme ,metalike troje e shpate me qendrueshmeri te larte. Projektim instalator : Instalime hidrosanitare.Linja e rrjeta elektrike - telefonike - radiotelefoni - citofoni -sistem alarmi - televiziv etj, perobjekte civile, industriale, turistike Sisteme komplekse te telekomunikacionit, Sisteme te furnizimit me gaz. Projektim veprash hidraulike : Diga - galeri - tunele hidraulike.Furnizim me uje - kolektore shkarkimi. Ujesjelles kanalizime urbane - rurale. Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditese - diga deri 10m - damba. Vepra te trajtimit te ujit. Vepra hidroteknike, marrjeuji, shkarkimi-kulla ekuilibri- porte- pontile, Vepra naftesjelles - gazsjelles - vajsjelles etj.

Projektim i prodhimit dhe shperndarjes se energjise ne : Centrale hidraulike (elektrik, primare, sekondare). Centrale termike (primare, sekondare). Impiante te prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike - diellore - era etj. Nen stacione elektrike, primarsekondar - linja te tensionit te larte. Kabina elektrike te rrjetit shperndares - linja te tensionit te ulet - te mesem. Projektim Sinjalistike rrugore ne : rruge lokale, rruge urbane dytesor edhe rruge interurbane dytesore. Sinjalistike ne autostrada, rruge urbane kryesore dhe rrugeinterurbane kryesore dhe ne degezime me hekurudhen Ne aeroporte dhe heliporte. Studime dhe projektme te ndertimit dhe mbylljes se venddepozitimeve te

2- Mbetjeve te ngurta urbane STUDIME TE SIZMOLOGJISE INXHINIERIKE
:Studime/ vleresime te sizmologjise inxhinierike per klasifikimin gjeosizmik te trojeve. Studime/ vleresime gjeologo-sizmike per trojet kundertohen objektet civile, sociale e kulturore. Studime/vleresime te sizmologjise inxhinierike per trojet kundertohen objekte te infrastruktures rrugore dhe hekurudhore te te gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte, etj. Studime/vleresime te sizmologjise inxhinierike per trojet kundertohen objekte komplekse si: hidrocentrale (pergdofuqi te instaluar), termocentrale, porte, aeroporte, tunele per vepra hidroteknike, bazamente pengarkesa te medha dhe objekte industriale. Studime/vleresime te sizmologjise inxhinierike per troje e shpate me qendrueshmeri te ulet dhe per troje ndertimore te shkrufta me mundesi lengezimi.Studime te rrezikut sizmik ne nivel rajonal (mikrozonimesizmike) dhe ne nivel kombetar (hartat kombetareterrezikutsizmik).Studime/Vleresim gjeollogo inxhinierik i truallit per objekte te medha H/C, porte aeroporte, bazamente me ngarkesa te medha. Studim/Vleresimgjeollogo inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet. Projektim rruge hekurudha :Rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore.Projektim rruge urbane kryesore dhe rruge interurbane kryesore.Shtresa rrugore e sistemim - asfaltme. Autostrada - aeroporte - heliporteShoqeria ka te drejte te marre pjese ne tendera, konkurime, siper marrje te cdo lloj natyre sipas veprimtarise qe do te kryej kjo Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar.

-Gjithashtu brenda kufijeve te percaktuar nga ligji mund te leshoje garanci, letra demshperblimi dhe cdo garanci tjeter reale .

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine tregtare ne perputhje me Legjislacionin shqiptar ne fuqi, si ate tregetar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore specifike per ushrimin e saj, sipas objektit te veprimtarise se saj, si dhe mbi bazen e Aktit te Themelimit si dhe Statutin e saj.

KREU II: KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11

Shoqeria cel Llogari Bankare ne leke vendi dhe cdo lloj valute, ne Banka vendase ose te huaja, private apo shtetore, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushrimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj.

Ortaket dhe Administratori Pergjithshem i caktuar prej tyre , depozitojne faksimilet e firmave te tyre origjinale ne Bankat ku eshte celur llogaria dhe terheqja e pjeseve te saj behet

kur Çeku bankar është firmosur nga Administratori i Shoqërisë, dhe në rastin kur Ortaket kanë caktuar më shumë se një Administrator, i cili është jashtë ortakerisë.

NENI 12

Pjesët e Kapitalit Themeltar, janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortaku ka të drejtë që të transferoj jashtë territorit të Republikës Shqiptare pjesërisht apo tërësisht Kontributet e saj përfshirë dhe Fondet e Kontributet në natyrë.

Transferimet e pjesëve të Kapitalit Themeltar, duhet të jenë të vertetuara me Kontrate Noteriale dhe për një gjë të tillë Ortaket duhet të marrin paraprakisht Vendimin me shkrim, i cili ushtron efektet juridike vepruese të tij, vetëm në rast se është legalizuar nga një Noter.

Shoqëria dhe të tretet, duhet të respektojnë këto Transferime sapo tu behen të ditura.

NENI 13

Kapitali Themeltar i Shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e Vendimit me shkrim që merret nga ortaket, i cili nënshkruhet prej tyre dhe dokumentohet duke bërë depozitim të tij në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit, e cila dhe e ka rregjistruar Shoqërinë Person Juridik.

KREU III:

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË, TË DREJTAT DHE DETYRAT

NENI 14

ASAMBLEJA

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimor i shoqërisë.

Vendimet e saj merren në përputhje me legjislativën në fuqi dhe me këtë Statut dhe janë të detyrueshme. Ato protokollohen në regjistër të veçantë në përputhje me ligjin.

Asambleja ka të drejtë të ushtronte në çdo moment verifikime mbi Administratorin/et dhe të kontrollojë çdo dokument të shoqërisë. Ajo mund të urdhërojë apo të udhëzojë administratorin/et në kryerjen e detyrës së tij.

Asambleja ka këto kompetenca:

- Vendos për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe strategjive të zhvillimit, përfshirë edhe investimet kapitale;
- Vendos për ndryshimet e statutit;
- Emeron dhe shkarkon Administratorin/et, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të Miratuar, si dhe përcakton shpërblimet e tyre;
- Vendos për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Mbikqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori, miraton buxhetin vjetor dhe raportin e ecurisë së cepimtarisë;
- Vendos për pjesëtimin e kuotave dhe/ose anulimin e tyre;
- Vendos për transferimin (blerjen, shitjen dhurimin, shkëmbimin) e pasurive të shoqërisë, për cedimin apo për dhenien me qira të shoqërisë ose degeve të saj, për dhenien me qira të aseteve të shoqërisë;
- Vendos për miratimin e huamarrjeve me interes nga të tretet;
- Vendos për dhenien e garancive hipotekore, pengut, barreve siguroese, dorezanise etj;
- Miraton Bilancet, pasqyrat financiare dhe raportet e eksperteve kontabel të miratuar;
- Miraton shpërdarjen e fitimit, nëpërmjet ndarjes së dividendeve ose vendos për kapitalizimin e tyre nëpërmjet zmadhimit të kapitalit;

- Miraton struktura organizative te shoqerise, rregulloren e brendeshme dhe organogramen, rregulloren e sigurimit teknik, si dhe politikat dhe nivelin e pagave dhe shperblimeve per cdo vend pune ne shoqeri;

Menyra e Thirrjes se Asamblese

Asambleja thirret nga Administratori/et ose nga ortakët e shoqerise, nëpërmjet një njoftimi me shkrim.

Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'i dërgohet të gjithë subjekteve te interesuar, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

Megjithatë janë te vlefshme edhe mbledhjet e Asamblesë qe nuk janë thirrur si me sipër, nëse është i përfaqësuar i gjithë kapitali dhe nese ne mbledhje asiston Administratori/et dhe eksperti kontabël i miratuar (nëse ben pjese ne struktura se shoqerise).

Ne Asamble duhet te marrin pjese te gjithë ata qe figurojnë te regjistruar ne librin e ortakeve.

Ortaku ka te drejtën e votës ne Asamble ne proporcion me kuotën qe zotëron ne kapitalin e shoqërisë.

Ortaku mund te përfaqësohet vete, ose nëpërmjet një personi te pajisur me prokure, i cili nuk duhet te jete administrator, apo ekspert kontabël i autorizuar ose vartës i vete shoqërisë apo ndonjë shoqërie tjetër te kontrolluar prej saj. I takon Administratorit/ve te verifikoje te drejtën e pjesëmarrjes për ortakun.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e përgjithshme merr vendim për vlerësimin e veprimtarisë së tij, shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij, ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria, dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Asambleja drejtohet nga Administratori/et dhe ne mungese te tij/tyre, pjesëmarrësit ne mbledhje, me shumice absolute te kapitalit prezent ne salle, zgjedhin një drejtues.

Asambleja emëron një sekretar edhe jashte bashkesise se ortakeve. Sekretari mban P/verbalin e mbledhjes i cili duhet te permbaje:

- a) daten kur eshte marre vendimi;
- b) identitetin e votuesve dhe kapitalin qe ata perfaqesojne;
- c) identifikimin e ortakeve pro, abstenues ose kundra;
- d) sipas kerkeses se ortakeve deklarimet e tyre mbi vendimin e marre;

Vendimi i Asamblesë duhet te nënshkruhet ortakun i vetem i shoqerise prezent ne mbledhje dhe ne munges te tij nga personi i autorizuar nga vete ai, si dhe nga sekretari. Kur e parashikon ligji, apo kur administratori e sheh te arsyeshme, P/Verbali i mbledhjes mbahet nga një noter i zgjedhur prej tij.

Kuorumi dhe Vendimarrja

Vendimet e Asamblesë qe merren me shumice te zakonshme, jane te gjitha vendimet e Asamblese per te cilat Ligji dhe Statuti nuk kerkojne nje shumice te cilesuar.

Vendimet qe merren me shumice te zakonshme jane te vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortakët (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se 30 për qind të kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Per Vendimet e Asamblesë qe merren me shumice te cilesuar, mbledhja eshte e vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortakët (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me $\frac{3}{4}$ e votave te ortakeve pjesemarres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar me sipër, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Merren me shumice te cilesuar keto vendime:

- Ndryshimi i Statutit;
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- Riorganizimi (shendrimi, bashkimi, ndarja) si dhe/ose prishja e shoqërisë,
- Shperndarja e fitimeve ose kapitalizimi i tyre;
- Prcaktimi i politikës dhe masës së pagave dhe shperblimeve për çdo pozicion pune në shoqëri, duke përfshirë edhe përcaktimin e pages apo shperblimit të Administratorit, ekspertit kontabel të miratuar dhe likuiduesve;

Asambleja e Përgjithshme me nismën e saj ose me kërkesën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar, mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

NENI 15

* **Ortakët** kryesisht dhe me anë të Administratorit, ushtrojnë dhe këto Tagra (të Drejta) :

Mundesohen për të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike që konsiderohen se janë të domosdoshme për ushtrimin e gjithanshem dhe fitimprures të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë sipas qëllimeve dhe objektivave të saj siç mund të jenë:

- 1. Të lidhin Kontrata të ndryshme që kanë për objekt perpunimit të lendeve drusore, blerje perpunim bërshish ulliri dhe nenprodukteve të tyre, blerje perpunim mbeturinash druri, prodhim peleti dhe eksport-import të këtyre prodhimeve etj.

Cdo blerje e pasurive të mesiperme, konsiderohet dhe si shtese e Kapitalit në Natyrë.

2. Të kryejnë çdo lloj veprimi pranë të gjitha Zyrave shtetërore dhe Private, Bankat e çdo niveli etj, që kanë të bëjnë me Garancite, Siper marrjet, marrjen e Kredive, të Siguracioneve dhe Risiguracioneve për jetën dhe Demet, Transportit (brenda vendit dhe jashtë shtetit) kryerjen e veprimeve doganore për zhdoganimin e mallrave të importuara deklarimin e atyre të eksportuar, plotesimit në kohë dhe me rregullsi të dokumentacionit Fiskal, Tatimor, Bankar etj.

NENI 16

ADMINISTRIMI

Administratori Përgjithshëm i Shoqërisë, caktohet; **Armando Nania**, atësia **Carmine Antonio**, shtetas Italian, lindur në Torre del Greco, Itali dhe banues në Milano, me adresë Alzaia Naviglio Pavese 20, 20143-Milano, Italia, lindur më 13/08/1976, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, poseduese e pasaportës biometrike Italiane nr.YA4533761 i cili qëndron në këto detyrë për një periudhë kohe **5 vjet**, duke filluar ky afat nga data e nënshkrimit të këtij Statuti, me të drejtë ripërteritje.

Administratori gëzon kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që Statuti ia njeh Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori ka të drejtën dhe detyrimin që:

- Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- Të zbatojë politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e përgjithshme;
- Të përfaqësojë shoqërinë tregtare përpara të tjerëve;
- Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Të përgatisë dhe të nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë;
- Të përgatisë buxhetin vjetor të shoqërisë.



- Te pregatisë propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe t'i paraqesë këto dokumente përpara Asamblesë për miratim;
- Te krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Te kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Te raportojë përpara Asamblesë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve të përsosme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Te propozojë dhe t'i paraqesë Asamblese për miratim strukturën organizative të shoqërisë, rregulloren e brendshme, organogramen dhe rregulloren e sigurimit teknik;
- Te mos kryejë veprimtari konkurruese (ndalimi i konkurrencës) me veprimtari që kryen shoqëria.
- Administratori ka të drejtën të rimbursohet për shpenzimet e bera për arsye pune si dhe të drejtën e një roge mujore të aprovuar nga Asambleja.

Administratori kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut. Ai mund të vere në lëvizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokate e duke lëshuar prokura në raste gjyqesh, duke kryer operacione bankare, këtu përfshirë edhe hapjen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e tërheqjeve dhe derdhjeve me leke në dorë apo urdhër xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Ortaket dhe Administratori Shoqërisë, i emëruar prej tyre, kanë të drejtë që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të Shoqërisë, të marrin në punë specialiste dhe shtetas të ndryshëm madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, duke lidhur Kontraten sipas kriterëve që parashikohen në Kodin e Punës në fuqi, të miratuar me Ligjin Nr.7961 dt.12.07.1995 dhe shtesat e mëpasme plotësuese të tij dhe me Ligjin "Për Sigurimet Shoqërore" si dhe në përputhje me rregullat teknike dhe të disiplinës profesionale të caktuara nga ana e punëdhësit

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori/et është përgjegjës individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkeljet ligjore të Statutit apo faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Shoqëria nuk është përgjegjëse ndaj të tretëve, për aktivitete të kryera nga Administratori/et në kundërshtim me kompetencat e tyre, kur vërtetohet se ata (të tretët) ishin në dijeni të kësaj rrethane.

Asambleja e përgjithshme mund t'i shkarkojë Administratorit/et në çdo kohë me shumicë të zakonshme, duke dhënë një motivacion. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU IV:

Pasqyrat Financiare dhe Shpërndarja e Shoqërisë.

NENI 17

Veprimet ekonomiko financiare të Shoqërisë, mbyllet me datën **31 Dhjetor** të çdo viti. Hartimi i Paqyrave Financiare vjetore, bëhet duke respektuar rregullat mbi Kontabilitetin dhe publikohen brenda 6 muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.

Për nxjerrjen e rezultatit Kontabel të Shoqërisë, mbi bazën e Aktivit dhe Pasivit, me vendim të Ortakeve caktohet një Ekspert Kontabel i Autorizuar.

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë dhe verifikojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë Ekonomiko tregtare të Shoqërisë, si atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollat

periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille mbi bazen e **Vendimit** te marre nga Ortaket e Shoqerise.

Ne perfundim te Kontrollit, Eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatatit perfundimtar te Bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese dhe dorezoje ne kohe Mbledhjes se Asamblese , i cili eshte Organi i vetem per ti shqyrtuar dhe vendosur miratimin e tij.

NENI 18

Nxjerrja e rezultateve te Pasqyrave Financiare vjetore, duhet bere me saktesi dhe duke respektuar te gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe Ligjeve Fiskale ne fuqi, te cilat jane te detyrueshme per tu zbatuar nga çdo subjekt privat qe ushtron veprimtari tregtare.

Eksperti Kontabel i autorizuar pervec te drejtave, ka dhe keto **detyrime**:

1. Garantoni Asamblen e Ortakeve se llogarite vjetore jane te rregullta dhe Bilanci eshte nxjerre me saktesi dhe konform rregullave te Ligjit " Mbi Kontabilitetin".

2. Te pasqyroje me vertetesi rezultatet e operacioneve te vitit te kaluar financiar dhe gjendjen reale financiare te Shoqerise ne mbylljen e vitit financiar te aktivitetit tregtar te saj.

3. Te verifikoje perputhjet me llogarite vjetore te Informacioneve te dhena nga Administratori Shoqerise dhe Ortakut, duke perfshire dhe dokumentat per gjendjen financiare qe ai (Administratori) i ka paraqitur Asamblese .

4. T'i beje te njohur Ortakeve dhe Administratorit te Shoqerise: Kontrollet dhe verifikimet qe jane bere prej tij per kontrolle periodike ose vjetore,duke vene ne dukje parregullsitate apo pasaktesite e konstatuar,masat ligjore per rregullimin e tyre etj.

5. Eksperti Kontabel i autorizuar eshte pergjegjes ndaj Shoqerise dhe ndaj te treteve per pasojat e demeshme te shkaktuara me fajin e tij (Dashje ose pakujdesi) aktivitetit tregtar te Shoqerise, por nuk eshte pergjegjes kur keto DEME shkaktohen pa dijenin e tij dhe nga veprimet me faj te Administratorit te Shoqerise.

NENI 19

Pasqyrat Financiare vjetore, miratohen mbi bazen e Vendimit me shkrim te marre nga Ortaket ne Mbledhjen e Asamblese, ne te cilen jo vetem qe dokumentohet aprovimi e tyre por vendos dhe ne lidhje me disponibilitetin e Fondeve ligjore, sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te aktivitetit te Shoqerise por dhe per Garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke patur parasyesh Fondin e Akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

Per Formimin e fondit rezerve, qe emertohet "**Rezerve e domosdoshme**" Ortaku vendos qe nga fitimi i akumuluar gjate vitit financiar, pasi te zbriten humbjet e vitit te meparshem, te lere te pakten **1/20 e vleres** se fitimit te realizuar.

NENI 20

Fitimi qe do te shpërndahet përbehet nga fitimet e realizuar gjate vitit financiar te sapo mbyllur.

Asambleja mund te vendose për formimin e fondeve te ndryshme dhe shpërndarjen e tyre.

Asambleja pasi ka miratuar Pasqyrat Financiare përfundimtar dhe ka vendosur shumën qe do te shpërndahet, përcakton pjesën e fitimit për secilin ortak ne raport me kuotën qe zotëron secili.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse Administratori, nen përgjegjësinë e tij personale, lëshon një certifikatë të aftësisë pagese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat nenit 77 te Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare"


ARMANDO NANIA

Dividendët qe nuk korrespondojnë me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakeve qe i kane marre ato.

NENI 21

Shperndarja ose Prishja e Shoqerise, mund te behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar Shoqeria siç mund te jene:

a. Humbja e Kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshe te veprimtarise se saj.
b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga Ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare".

c. Me kerkesen e Ortakut Themelues.

Ne kete rast Ortaku merr Vendim me shkrim ne te cilin parashikon dhe menyren e Likudimit te Shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe leshuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e Likuidatorit.

07.

NENI 22

Akti i Emerimit te Likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon Ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

NENI 23

Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korekt si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cilave Shoqeria eshte Kreditore dhe per ekzekutimin e plote te detyrimeve (debive) qe Shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te veçante apo personave fizike ose juridik vendas apo te huaj.

NENI 24

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise mes te treteve, si rregull dhe pergjithesisht duhet te zgjidhet ne mirekuptim ne te kunderten çeshitjen mund ta bejne objekt konflikti gjyqesor, duke ngritur padi ne **Gjykatën e rrethit Tirane**.

NENI 25

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut i referohet udhezimeve plotesuese e konform akteve ligjore e nenligjore ne fuqi, te dhena nga Ortaku vetem themelues i Shoqerise si dhe hapsirave juridike lejuese te Legjislacionit ne fuqi dhe normave nderkombetare.

NENI 26

Ky STATUT u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe dhe me permbajtje e vlera te njejta juridike dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket Themelues te Shoqerise tregtare "**Selia Qendrore e Shoqerise "Diarma Consulting" Sh.p.k** eshte ne adresen:

Rruga Rrapo Hekali prane Njesise Administrative nr 13 kati 2 Tiranë-Albania.(Nr.kontakti Celular 00393478419038, e-mail armando.nania@outlook.com), nenshkruhet ne te gjitha ekzemplaret duke u vene emri, mbiemri dhe firma origjinale.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

"Diarma Consulting" Sh. p. k.

Rruga Rrapo Hekali prane Njesise Administrative nr 13 kati 2 – Tiranë-Albania


ARMANDO NANIA